



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
*Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*

Nr. 598 Prot.

Pukë, më 01/04/2025

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: ZNJ. ERA SHERIFAJ

Adresa: Rruga Elbasanit, Ndërtesa Park Gate, Kati 10, Apartamenti 71/73, PO BOX: 2418/1, 1010

TIRANË

Në përgjigje të kërkesës për informacion, drejtuar Bashkisë Pukë, informojmë si më poshtë:

1. Bashkia Pukë, për periudhën **janar-dhjetor 2024**, nuk ka patur **buxhet vjetor të planifikuar për rininë**.
2. Numri total i punonjësve për vitin 2024 ka qenë 347, prej të cilëve 170 femra dhe 177 meshkuj.
3. Pranë Bashkisë Pukë për vitin 2024 janë punësuar individë të moshës 18-29 vjeç gjithsej 6, prej të cilëve 4 janë femra dhe 2 janë meshkuj. Asnjë prej tyre është person me aftësi të kuafizuar.
4. 1 person i gjinisë femërore punësuar në 2024 mban pozicion drejtues. 0 persona me aftësi të kufizuara.
5. Bashkia Pukë nuk ka politika rinore të zhvilluara specifiku për grupmoshën 15-29 vjeç, kjo për arsyen e thjeshtë të mosfunksionimit të një strukture të posaçme dhe mungesës së burimeve financiare.
6. Në institucionin tonë nuk kemi struktura përgjegjëse për politikën rinore.
7. E vetmja strukturë rinore e ngritur në bashki është këshilli rinor vendor.
8. Për ngritjen e këshillit rinor vendor kemi bashkëpunuar me grupe të rinjsh dhe individë.
9. Nuk kemi plan veprim për Këshillin Vendor. Për vitin 2024 nuk është organizuar asnjë aktivitet nga KVR-ja.
10. Ne kemi nevojë për mbështetje financiare, pasi buxheti i bashkisë nuk planifikon asgjë në këtë drejtim.
11. Në KVR janë përfshirë 5 të rinj, prej të cilëve 3 femra dhe 2 meshkuj. Asnjë nuk i përket personave me aftësi të kufizuara.
12. Po, kemi patur disa iniciativa dhe veprimtari bashkëpunuese me të rinj, të cilat kanë konsistuar në sensibilizimin dhe rolin e të rinjve në vendimmarrjet lokale.
13. Pjesëmarrja e të rinjve në dëgjesat publike, mund të themi se është e ulët, për shkak të mjeteve jo efektive që përdor institucioni në përfshirjen e të rinjve në proceset e saj.
14. Mjetet e komunikimit që përdor bashkia Pukë janë:  
Website: <https://bashkiapuke.gov.al/>  
Facebook: <https://www.facebook.com/profile.php?id=100094947398546>

15. Numri total i përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike për vitn 2024 është 1005. Femra 516, meshkuj 489.
16. Numri I të rinjve (15-19 vjeç) përfitues të skemës së ndihmës ekonomike për vitin 2024 është 146 gjithsej. Femra 85, meshkuj 62.
17. Numri total i përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar për vitn 2024 është 428 gjithsej, prej të cilëve femra 212 dhe meshkuj 206.
18. Numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të pagesë së aftësisë së kufizuar për vitin 2024 është 48. Femra 29, meshkuj 19.
19. Numri total i personave të cilët janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2024 është 9. Femra 5, meshkuj 4.
20. Numri i të rinjve të cilët janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2024 është 2. Femra 2, meshkuj 0.

Faleminderit për mirëkuptimin!

**KRYETARI**

**Rrok DODAJ**

